



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**KËSHILLI QARKUT SHKODËR
KRYETARI**

V E N D I M

Nr.12, Datë:22.07.2021

**“PËR SHITESË PLANI NË BUXHETIN E KËSHILLIT TË QARKUT SHKODËR PËR
VITIN 2021”**

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 22.07.2021, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi dëgjoj materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit “Për shtesë plani në Buxhetin e Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2021” bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 137/2020“Per Buxhetin e Vitit 2021”, pikat 1, 2/b të nenit 21 të Ligjit nr. 68/2017”Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018” Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit Udhëzimin nr.4, datë 25.01.2021 ”Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021” pika 98, shkresën nr. 630/31, datë 18/06/2021 të Ministrisë së Shëndetsisë dhe Mbrojtjes Sociale ”Njoftim”, dhe shkresën nr. 333/42, datë 30.06.2021”Akordimi i fondeve për financim në ofrimin e shërbimeve të përkujdesit në Qarqe për 6 mujorin e dytë”, Rregullores për Organizimin dhe Funkcionimin e këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht neni 12,13, dhe 15 i saj. Bazuar në Aktin Normativ Nr.03 datë: 15.03.2020 konkretisht neni 5, ” për vendimarrjen e organeve kolegjiale gjatë gjendjes së infeksionit Covid-19”, si dhe bazuar në Urdhërin Nr.80 datë 17.11.2020 “për miratimin e rregullave dhe procedurave standarde të punës të harmonizuara, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19...

Duke marrë shkas nga situata e krijuar nga pandemia Covid-19, mbledhja e Këshillit të Qarkut Shkodër u zhvillua online nëpërmjet platformës Zoom, , pas relatimit nga zyra e drejtorisë së financës dhe buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **11 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim.**

Në përfundim Këshilli i Qarkut Shkodër



VENDOSI:

1. Miratimin e shtesës së planit të buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2021(Periudha korrik-dhjetor 2021), me burim financimi Transfertën e Kushtëzuar nga MSHMS, për financimin në ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror rezidencial për persona me aftësi të kufizuara të grupmoshës 30-60 vjeç, në shtëpinë familje “Facibeni”, ofruar nga Shoqata “Opera della Providenza Madonnina della Grappa”, në programin 10430 ,Art 6060000, shpenzime korente, shumën 3,023,709 lekë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkoder .
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

KRYETARI
Hilmi LAKTI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**KËSHILLI QARKUT SHKODËR
DREJTORIA E FINANCËS & BUXHETIT**

RELACION

**“PËR SHITESË PLANI NË BUXHETIN E KËSHILLIT TË QARKUT
SHKODËR PËR VITIN 2021”**

Këshilli i Qarkut Shkodër për vitin 2021, bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 137/2020 “Per Buxhetin e Vitit 2021” pikat 1, 2/b të nenit 21 të Ligjit nr. 68/2017”Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018” Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit Udhëzimin nr.4, datë 25.01.2021 ”Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021” pika 98, propozon shtesën e planit të buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2021, për financimin në ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror rezidencial për persona me aftësi të kufizuara të grupmoshës 30-60 vjeç, në shtëpinë familje “Facibeni”, ofruar nga Shoqata “Opera della Providenza Madonnina della Grappa”, në programin 10430 ,Art 6060000, shpenzime korente, shumën **3,023,709 lekë**.

Me shkresën nr. 630/31, datë 18/06/2021 te MSHBS “Njoftim” si dhe me shkresën nr. 333/42, datë 30.06.2021”Akordimi i fondeve për financim në ofrimin e shërbimeve të përkujdesit në Qarqe për 6 mujorin e dytë”, jemi njoftuar për shtese fondi nga Ministria e Shëndetsisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, të cilat do të përdoren për shpenzime korrente të shtëpisë familje “Facibeni”, ofruar nga Shoqata “Opera della Providenza Madonnina della Grappa”, për periudhën korrik deri dhjetor 2021.

Shoqata “Opera della Providenza Madonnina della Grappa”, ushtron aktivitetin e saj prej 25 vitesh dhe strehon persona me aftësi të kufizuara të grupmoshës 30-60 vjeç.

Misioni i kësaj shoqate është përmirësimi i cilësisë së jetës dhe nxitja e integritimit social të përfituesve ndërmjet ofrimit të shërbimeve të përkujdesit social rezidencial për persona me aftësi të kufizuara.

Shërbimet që ofrohen në qënder janë;

- ✚ Shërbimi rezidencial,
- ✚ Shërbimi mjekësor
- ✚ Shërbimi psiko-social,
- ✚ Aktivitete sociale ,kulturore,vizita
- ✚ Shërbimi sanitar.

Nisur nga kërkesat e bëra nga shoqata dhe nga ana e jonë, Ministria e Shëndetsisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, ka akorduar fondin prej **3,023,709 lekë**, I cili do të përdoret sipas nevojave të shoqatës dhe sipas shkresës së Ministrisë për qëllimin e ardhur, pasi këto janë fonde të transfertës së kushtëzuar, për 6 mujorin e dytë të viti 2021.



Nëpunësi Zbatues

Gjyljana MIRUKU

